



**KONTRATË PËR ÇELJE DEPOZITE ME AFAT**

E lidhur sot, më datë 15/08/2016, në ambientet e Bankës Societe Generale Albania – Dega Twin Towers, midis Z. ARTI MESITI me nënshtetësi Shqiptare, me atësi FEJZI, i datëlindjes 16/10/1984, mbajtës i pasaportës nr. Z 1212889, lëshuar më datë 13/10/2004, me adresë, SHEMRIZE-GRAMSH , GRAMSH dhe Zj. SIDORELA MESITI me nënshtetësi Shqiptare, me atësi RAMAZAN, e datëlindjes 06/05/1989, mbajtëse e pasaportës nr. Z 2096134, lëshuar më datë 03/02/2007, me adresë, SHEMRIZE-GRAMSH , GRAMSH në vazhdim cilësuar “Klientët”, dhe BANKES SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A., me seli në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Twin Towers, Kulla 1, Tiranë, e përfaqësuar nga Drejtori i Degës, Zj. Shpresa Zeqiraj, dhe Bankieri Personal, Zj. DORINA MATAJ, në vazhdim cilësuar “Banka”, të cilët bien dakord për çeljen e depozitës me afat me kushtet që vijojnë më poshtë:

1. Numri 307612.
2. Shuma e depozituar prej klientit 1,000.00 (një mijë).
3. Monedha EUR.
4. Afati 1 muaj.
5. Norma e interesit 0.01 %.
6. Data e maturimit 15/09/2016
7. Për të kryer veprime klientët do të paraqiten: Veç e veç
8. Depozita ditën e maturimit: Do të rinovohet  
Nëse depozita ditën e maturimit nuk do të rinovohet atëherë Klientët duhet të paraqitet në Bankë brenda 30 ditëve nga data e maturimit të depozitës. Nëse Klientët nuk paraqiten në Bankë brenda këtij afati, fondet në llogari mbështetëse do të transferohen në një llogari rrjedhëse ku do të aplikohen kushtet e punës në fuqi.
9. Depozita do të rinovohet (me të njëjtin afat) për: Principali, ndërkohë që interesat do të kalojnë të lira në llogarinë mbështetëse nr. 00001064371
10. Klientët njohin dhe respektojnë Kushtet e Punës, bashkëngjitur dhe pjesë e pandarë e kësaj kontrate.
11. Klientët pohojnë se të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me depozitën do të kalojnë nëpërmjet llogarisë mbështetëse me numër 00001064371.
12. Klientët do të paraqesin pranë Bankës kopjen origjinale të kontratës në momentin që do të paraqiten për të mbyllur depozitën.
13. Klientët mund të kryejnë veprime në depozitën me afat pa prishur interesin vetëm ditën e maturimit, në këtë rast ai do të pajset me një kontratë të re. Nëse dita e maturimit të depozitës është ditë pushimi zyrtar, dita e parë e punës do të konsiderohet si ditë maturimi.
14. Në rast se klientët vendosin të tërheqin një pjesë ose të gjithë shumën e depozituar para afatit të maturimit, atëherë depozita mbyllet dhe Banka i paguan atyre interesin e llogarit me normën e interesit të llogarisë rrjedhëse për ditëqëndrimin e shumës në depozitë.
15. Per interesin e fituar, Banka mban ne burim vleren e tatimit mbi te ardhurat ne masen sikurse eshte parashikuar ne ligjin e aplikueshem per “Tatimin mbi te ardhurat”. Interesi neto IN i fituar nga klientët do të  
$$I_n = \frac{P * i * d}{365} * (1 - t)$$
  
llogaritet me formulën:  $\frac{3650se366}$ , ku P është principi, i është norma e interesit, d janë ditët e qëndrimit (afati) dhe t është norma e tatimit.
16. Banka merr përsipër të respektojë Kushtet e Punës dhe Buletinin e Normave të Interesit, bashkëngjitur dhe pjesë e pandarë e kësaj kontrate.
17. Banka garanton depozitat e klientëve sipas ligjit për Sigurimin e Depozitave, sipas kushteve të reklamuar në sportelet e saj.
18. Në rast se Banka ka dyshime për burimin e fondeve të depozituara nga klientët, ajo do të ndjekë procedurat normale të raportimit në kuadrin e Parandalimit të Pastrimit të Parasë dhe Luftës Kundër Terrorizmit. Banka ka të drejtë që për çdo transaksion të kërkojë sqarime dhe të bëjë verifikime, për të dalë qartë burimi i parave që përdoren për transaksionin dhe përfituesin e këtij transaksioni, si dhe të evidentojë këto burime. Banka informon Autoritetin Përgjegjës edhe për rastet kur ka të dhëna për pastrimin e parave, pavarësisht se shumica mund të jetë nën kufirin e parashikuar nga ligji.
19. Çdo njoftim, kërkesë ose komunikim midis palëve do të bëhet me shkrim dhe do të dërgohet me letër rekomandë ose postë të regjistruar në adresat e tyre të përcaktuara në këtë kontratë ose në adresat e njoftuara më pas nga secila prej palëve dhe do të konsiderohet i / e dorëzuar në momentin e nënshkrimit të dokumentit përkatës të marrjes në dorëzim nga pala pritëse, dhe në rast se ajo nuk gjendet, njoftimi i dorëzohet njërit prej anëtarëve të familjes. Në rast se njoftimi nuk arrihet t'i komunikohet klientit për shkak se nuk gjendet në adresën e përcaktuar në kontratë dhe njoftimi kthehet mbrapsht me shënimin se nuk gjendet në adresën e njoftuar apo ka ndryshuar vendbanimin/adresën, për të cilën nuk e ka njoftuar Bankën, në këtë rast Banka do ta konsideroj njoftimin kundrejt klientit të komunikuar. Banka mund t'i njoftojë klientët edhe duke përdorur mjetet e komunikimit elektronik, nëpërmjet e – mail – it, në rast se ata kanë deklaruar një adresë të tillë. Në këtë mënyrë Banka do të njoftojë klientët për ndryshime në Kushtet e Punës dhe në Buletinin e Normave të Interesit (nëse ka ndryshim në normat e interesit të depozitave me afat), para bërjes efektive të këtyre ndryshimeve.
20. Banka do të mbajë përgjegjësi në rastet e neglizhencës së rëndë ose të veprimit të mashtrimit me dashje të punonjësve të saj. Depozituesit marrin përsipër rrezikun e falsifikimit në të gjitha rastet kur urdhërat në lidhje me depozitën nuk janë dhënë personalisht në Bankë.
21. Në rast se kontrata e lidhur midis klientëve dhe Bankës është me normë preferenciale interesi, kjo e fundit është objekt i rishikimeve sa herë që depozita maturohet.
22. Kjo kontratë përpilohet në 2 (dy) kopje origjinale, njërën nga të cilat e marrin klientët, ndërsa tjetra qëndron në Bankë. Me nënshkrimin e saj, klientët pranojnë pa kufizim kushtet e mësipërme.
23. Çdo ndryshim apo shtesë e dispozitave të kësaj kontrate do të bëhet me marrëveshje të shkruar midis palëve.
24. Kjo kontratë i nënshtrohet dhe drejtohet nga ligjet e Republikës së Shqipërisë. Çdo mosmarrëveshje do të zgjidhet me mirëkuptim midis palëve, në të kundërt ato do t'i drejtohen Gjykatës.

**Banka Societe Generale Albania SH.A**

**PALËT KONTRAKTUESE**

**Klientët**

**Bankieri Personal**

**ARTI MESITI**

**SIDORELA MESITI**

## ANEKS I KONTRATËS SË DEPOZITËS PËR INFORMIMIN E PUBLIKUT

Nëse një depozitë që është e rregullt dhe e pagueshme, nuk paguhet nga një bankë për arsye të cilat lidhen direkt me gjendjen e saj financiare, depozituesit paguhen/kompensohen nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave.

Depozitat e zj./z.Z. ARTI MESITI dhe Zj. SIDORELA MESITI janë të siguruara dhe kompensohen nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave.

Ky kompensim arrin shumën prej 2,500,000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë për bankë. Kjo do të thotë që të gjitha depozitat në të njëjtën bankë janë agreguar që të llogaritet kufiri i mbulimit/kompensimit. Nëse p.sh. një depozitues ka një depozitë me afat prej 1,500,000 (një milionë e pesëqind mijë) lekë dhe një depozitë pa afat prej 6,500,000 (gjashtë milionë e pesëqind mijë) lekë, atij ose asaj do t'i kompensohet vetëm 2,500,000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë.

Në rastet e depozitave të përbashkëta me të drejta të njëjta, kufiri prej 2,500,000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë zbatohet për secilin depozitues.

Në rastin e depozitave me person të autorizuar, sigurohet dhe kompensohet vetëm titullari i depozitës.

Nëse në ditën e ndërhyrjes depozituesi ka në subjektin e siguruar një depozitë dhe një kredi, depozita e siguruar krahasohet me nivelin 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë dhe prej saj zbritet shuma e detyrimeve që rezultojnë në vonesë shlyerjeje në ditën e ndërhyrjes. Shuma e gjetur kompensohet.

Të gjitha depozitat që janë në monedhë të huaj, konvertohen në lekë me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në ditën e kalimit të bankës në likuidim.

Në përgjithësi të gjithë depozituesit individë janë të mbrojtur nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave. Të gjitha përjashtimet nga kjo mbrojtje janë të përcaktuara në ligjin "Për sigurimin e depozitave", dhe mund të gjenden në faqen zyrtare të Agjencisë, [www.asd.gov.al](http://www.asd.gov.al). Banka juaj, gjithashtu, mund t'ju informojë për çdo hollësi të mëtejshme në lidhje me sigurimin ose jo të depozitës suaj. Kjo duhet të konfirmohet dhe në kontratën e depozitës, si dhe në printimin e gjendjes së llogarisë suaj.

Agjencia e Sigurimit të Depozitave, me adresë rruga e Elbasanit, pallati Edilalit, zyra 317, Tiranë, Shqipëri, telefon: +355 4 362 989, 347 298, faqja zyrtare [www.asd.gov.al](http://www.asd.gov.al), është përgjegjëse për realizimin e procesit të kompensimit brenda tre muajve.

Nëse nuk jeni kompensuar brenda këtij afati, duhet të kontaktoni me Agjencinë e Sigurimit të Depozitave.

Depozita juaj është e siguruar nga një skemë e sigurimit të depozitave, gjë që do të thotë që të gjitha bankat janë anëtare të kësaj skeme dhe ndihmojnë njëra tjetrën për të shmangur falimentimin e ndonjë banke. Por sidoqoftë nëse falimentimi i ndonjë banke do të ndodhë, depozitat tuaja do të kompensohen deri në 2,500,000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë.

## DEPOZITUES

## KLAUZOLA E PËLQIMIT PARAPRAK SI PJESË E KONTRATËS SË DEPOZITËS

Nëpërmjet kontratës së depozitës deklaroj se i gjithë informacioni që kam dhënë është i saktë dhe i plotë.

Duke kuptuar se, të dhënat e mia demografike dhe financiare të ruajtura në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave do të trajtohen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin bankar si dhe sekretin profesional, si dhe për faktin se Banka "SOCIETE GENERALE ALBANIA" SHA dhe Agjencia në kuadër të Sistemit Informatik për Raportim dhe Kompensim kanë marrë të gjithat masat e nevojshme për të garantuar trajtimin e sigurt të të dhënave të mësipërme:

Autorizoj Agjencinë e Sigurimit të Depozitave që, për qëllimet që përfshijnë:

1. Vlerësimin e formularit të depozitimit të vlerave monetare;
2. Vlerësimin e besueshmërisë time si person depozitues ose përfitues i depozitës;

të njihen me detyrimet depozitë të bankave/ degëve të bankave të huaja/ subjekteve ndaj meje, nëpërmjet përpunimit të autorizuar të të dhënave/informacionit të Sistemit Informatik për Raportim dhe Kompensim, në mënyrë që të vlerësojë sasinë e detyrimeve financiare, garancitë dhe besueshmërinë/aftësinë për të shlyer këto detyrime financiare nga subjekti në të cilin janë depozituar vlerat e mia monetare.

Gjithashtu, jap pëlqimin tim që Banka "SOCIETE GENERALE ALBANIA" SHA të përdorë emrin dhe të dhënat e mia identifikuese dhe financiare që mbahen në regjistrin elektronik të tyre, për kryerjen e raportimeve standarde dhe të detyrueshme në Sistemin Informatik për Raportim dhe Kompensim të Agjencisë.

## DEPOZITUES